


**AKT THEMELIMI**  
**I**  
**SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR**  
**" DENIS CONSTRUCTION" SHPK**



**NENI 1**  
**ORTAKU I SHOQERISE**

Sot, ne Tirane, me date 15/02/2023 ne mbeshtetje te Ligjit nr. 9901, dt.14.04.2008, "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare" si dhe te Ligjit nr. 9723, dt. 03.05.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit" me vullnetin e tij te lire te shprehur bazuar me kete Aktin Themelimi po krijohet shoqeria:

**"DENIS CONSTRUCTION" SHPK** nga ortakut I *vetem Avni Mula, atësia Vebi, amësia Xhemile, shtetas Shqiptar, lindur në Kukës dhe banues në Tiranë, me adresë Jordan Misja; Nd. 42; H. 1; Ap. 42; Njësia Administrative Nr. 9; Njësia Bashkiake Nr. 9; 1016; Tiranë, lindur më 10/04/1986, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, pajisur me Leternjoftim ID nr. 034322946 dhe nr. personal I60410151K. i cili zoteron 100% te pjesemarrjes ne kapitalin e shoqerise, dhe ka hartuar aktin e themelimit te shoqerise si me poshte vijon:*

**Neni 2**

**Emri i shoqerise**

2.1 Emri i shoqerise eshte " **DENIS CONSTRUCTION" SHPK** .

**Neni 3**

**Forma ligjore**

3.1 Shoqeria eshte e formes me pergjegjesi te kufizuar (SHPK), ne baze te ligjit Nr.9901,date14.04.2008, "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare".

3.2 Shoqeria mund te shnderrohet ne nje forme tjeter me vendimin e Asamblese se Ortakut te Vetem.

**Neni 4**

**Baza ligjore**

4.1 Shoqeria " **DENIS CONSTRUCTION" SHPK** do te kryje veprimtarine e saj ne perputhje me kete Statut, me Ligjin nr. 9901, date 14.04.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare" si dhe dispozitat e tjera te Legjislacionit Shqiptar ne fuqi.

**Neni 5**

**Kohezgjatja**

5.1 Shoqeria do te ushtroje veprimtarine per nje kohe mbi 10 vjet .

5.2 Veprimtaria e Shoqerise fillon qe nga momenti i regjistrimit te saj ne Qendren Kombetare te Biznesit,Tirane.

**Neni 6**

**Selia**

6.1 Selia e shoqerise eshte ne adresen: Tirane, Blv. Zogu I, Rr. Dervish Hatixhe, P64, Shk 1, Ap.1.

6.2 Selia e shoqerise mund te ndryshoje me vendim te Ortakut te Vetem te shoqerise.

6.3 Shoqeria ka te drejte te krijojë dege, filiale ose/dhe zyra perfaqesimi ne te gjithe territorin e Republikës se Shqiperise si dhe jashte vendit.

6.4 Shoqeria mund te marre pjese ne shoqeri te tjera ekzistuese ose ne shoqeri qe ne te ardhmen do te zhvillojne veprimtari ne territorin e Republikës se Shqiperise dhe jashte tij me vendim te ortakut te vetem te saj.

**Neni 7**

**Vula**

7.1 Shoqeria do te kete vulen e saj qe do te perdoret nga administratori.

7.2 Forma e vules dhe permasat e saj do te percaktohen nga Ortaku i vetem i shoqerise, ne perputhje me kerkesat perkatese ligjore ne Shqiperi.

## Neni 8 Objekti

### 8.1 Objekti veprimtarise se shoqerise eshte:

Prodhim dhe tregtim te materialeve te ndertimit, projektme ne fushen e ndertimit,ndertime, rikonstruksione, punime komunale sherbim ne dertime hidroteknike, kanalizime, ujesjellsa, elektrike,rruge e sistemime, transportim mallrash e pasagjeresh brenda e jashte vendit, tregtim te artikujve te ndryshem industriale e ushqimore. Grumbullimi dhe transporti i mbetjeve inerte.

Trajtim/magazininim ose trajtim i mbetjeve te tjera te ujerave te zeza urbane: ujerat e ndotura, llumin septik, mbetjet e ujerave te zeza. Hartimi i raporteve te vleresimit te ndikimit ne mjedis dhe auditim mjedisor.

Ndertime civile dhe ekonomike, ndertime civile, industriale turistike, bujqesore deri ne 5 kate, ndertime civile dhe ekonomike, ndertime civile, industriale turistike, bujqesore mbi 5 kate, rikonstruksione, ndertim banese, ndertim banese mbi 8 kate. Ndertime rrugore, ndertim rruge kategoria IV dhe V, ndertim rruge kategoria III dhe II, Punime te mirembajtjes dhe sinjalizimit ne rruge, ndertim mbi shtresa rrugore. Ndertim autostrade - pista - aeroporte - helioporte. Ndertim hekurudhore, punime hekurudhore, punime speciale te shinave dhe traversave, punime ne sistemin elektrik dhe te sinjalizimit. Ndertim ura dhe vepra arti deri ne 10m, ndertim ura dhe vepra arti mbi 10m.

Ekstrakada-ura metalike- te varura, ndertim tunele rrugorehekurudhore, ndertime detare, ndertime portuale-bankinabasene-pontile, punime thellimi-drenimi.

Ndertime 2 hidraulike, kanale e impiante vaditje, punime mbrojtje te sistemit hidraulik-cimentime etj. ndertim impiante te sistemit te ujit, ndertim vajsjelles, gazsjelles, naftesjelles, ndertim diga-damba deri ne10m, ndertim galeri-tunele, ndertim diga te larta. Vepra te vecanta punime speciale, sillose, kulla, kulla uji etj., B/arme metalike, perforcimeperforcime themeli e punime nentokesore, izolime mbi dhe nentokesore nga ujrat, themele te vecanta, puse shpime gjeologo-inxhinjerike, cpime per uje.

Punime restaurimi, restaurim i ndertesave monument kulture, punime restaurimi ne vepra arkeologjike. Punime karpenterie. Punime sherbimi, punime ne siperfaqe te gjelberta parqe-pyll parqe, pastrimi i siperfaqeve urbane, kryerja e punimeve dhe sherbesat funerale, mirembajtja dhe zhvillimi i dekorit ne mjedise urbane-ndericimi e sinjalizimi urban. Prodhim asfalti, prodhim betoni, prodhim parafabrikate betoni.

Çdo aktivitet tjetër te lidhur me aktivitetin kryesor ne perputhje me legjislacionin e zbatueshem shqiptar.

### 8.2 Objekti i shoqerise mund te zgjerohet ose ndryshoje me Vendim te Asamblese se Ortakut te Vetem.

## Neni 9 Kapitali

9.1 Kapitali themeltar i shoqerise eshte 100,000(njeqindemije) leke, i nenshkruar dhe pagesa e tyre eshte bere ne kesh ne arken e shoqerise.

9.2 Kapitali eshte i ndare ne 1(nje) pjese(kuota), dhe zoterohet nga:

1. Z. Avni Mula , i cili zoteron 1 kuote dhe 100% te pjesemarrjes se kuotave ne kapital e cila ne vlere leku eshte 100,000 leke(njeqinde mije leke).

## Neni 10

### Transferimi i pjeseve te kapitalit themeltar

10.1 Pjeset e kapitalit themeltar mund te transferohen vetem me akt noterial.

- 10.2 Pjeset e kapitalit mund t'u transferohen edhe te treteve me vendim te ortakut te vetem te shoqerise. Pjeset e kapitalit transferohen ne rruge trashegimnie pasi te jete marre Vendimi i Ortakut te vetem lidhur me kalimin e pjeseve te kapitalit tek trashegimtaret.

#### Neni 11

##### **Zmadhimi/Zvogelimi i kapitalit themeltar**

- 11.1 Ortaku I vetem I shoqerise mund te zmadhojne ose zvogelojne kapitalin themeltar me vendim te tyre. Zvogelimi i kapitalit themeltar do te kryhet brenda kufijve te lejuar nga ligji.

## **2. ORGANET E SHOQERISE**

#### Neni 12

##### **Asambleja e Ortakut te Vetem**

- 12.1 Asambleja e Ortakut te vetem eshte organi me i larte vendimor i shoqerise.
- 12.2 Asambleja e Ortakut te vetem drejton veprimtarine e shoqerise nepermjet marrjes se vendimeve. Mbledhjet e Asamblese jane te zakonshme.

#### Neni 13

##### **Asambleja e Zakonshme**

- 13.1 Asambleja e zakonshme vendos ne cdo rrethane ne emer te shoqerise. Ajo merr te gjitha vendimet (emerimi dhe shkarkimi i administratorit/eve, miratimin e bilancit te shoqerise, etj.) me perjashtim te atyre vendimeve qe ne baze te Ligjit ose Statutit jane ne kompetence te Asambese se jashtezakonshme.
- 13.2 Asambleja e zakonshme i merr vendimet nga ortakët e saj me 51% te votave.

#### Neni 14

##### **Thirrja dhe Perfaqesimi ne Asamble**

Mbledhja e Asamblese se Ortakut te Vetem mund te thirret ne cdo kohe nga:

- Administratori/Administratorete;
- Ortaku i shoqerise
- Dhe cdo arsye tjeter konform ligjit

#### Neni 15

##### **Njoftimi dhe Zhvillimi i Mbledhjeve**

- 15.1 Mbledhjet zhvillohen ne seline e shoqerise ose ne cdo vend tjeter te njoftuar nga administratori/njeri prej administratoreve.
- 15.2 Njoftimi kryhet me shkrim, me telegram, me leter rekomande, dhe poste tjeter te regjistruar, te pakten 15 dite perpara dates se zhvillimit te mbledhjes dhe permban daten, vendin, oren dhe rendin e dites se mbledhjes.

#### Neni 16

##### **Marrja e vendimeve**

- 16.1 Vendimet merren nga ortakut i vetem i saj me 100% te votave.

#### Neni 17

##### **Administrimi**

- 17.1 Administrimi i shoqerise kryhet nga nje administrator ose nga nje grup administratorësh qe caktohet nga Asambleja e Ortakut te Vetem.
- 17.2 Administratori/ret nuk eshte detyrimisht ortak i shoqerise.

- 17.3 Administratoret veprojnë në mënyrë të pavaruar.
- 17.4 Administratori/ret kanë të drejtë të përfaqësojnë shoqëritë dhe të drejtojnë punën e përditshme të shoqërisë në përputhje me udhëzimet e Asamblesë së Ortakut të Vetem.
- Administratori është solidarisht përgjegjës për veprimtaritë e mëposhtme:
    - drejtimin e veprimtarisë së përditshme të shoqërisë;
    - perfaqësimin e shoqërisë në marrëdhëniet me të tretet personalisht ose duke caktuar zëvendës.
    - perfaqësimin e shoqërisë në marrëdhëniet me të tretet personalisht ose duke caktuar zëvendës, veçanërisht në marrëdhëniet me bankat e nivelit të dytë dhe institucionet e tjera të kreditit, për hapjet e llogarive bankare dhe marrjen e kredive.
    - pergatitjen e mbledhjeve të Asambleve të Ortakeve;
    - hartimin dhe mbajtjen e kontabilitetit vetë ose emërimin e një kontabilisti të miratuar ose të një eksperti kontabel;
    - pergatitjen e dokumenteve në emer të shoqërisë sipas kompetencave që ka;
    - lidhjen kontratave pune dhe të zgjidhjen ato sipas rastit;
    - Zhvillimin veprimtaritë të tjera të çdo lloji natyre për të mirën e shoqërisë dhe realizimin e objektivit të saj.
- 17.5 Shoqëria do të administrohet nga një administrator i cili do të jetë:
- z. Avni Mula i cili emërohet në këto detyra për një afat kohor prej 5 (pese) vjet i cili fillon më 15.02.2023 deri më 14.02.2028.

#### **Neni 18**

#### **Viti financiar**

- 18.1 Viti financiar i shoqërisë përputhet me vitin kalendarik, duke filluar në 1 janar dhe mbaron më 31 dhjetor.

#### **Neni 19**

#### **Bilanci. Mbajtja e kontabilitetit**

- 19.1 Bilanci vjetor i Shoqërisë shqyrtohet në mbledhjet e Asamblesë së Ortakut të vetem dhe I paraqitet organeve tatimore deri në fund të muajit mars të vitit pasardhës.
- 19.2 Kontabiliteti mbahet në gjuhën dhe në monedhën Shqiptare. Shoqëria mund të ketë edhe llogari të vecanta në valute.
- 19.3 Shoqëria mund të marrë financime nga ortakët, institucione financiare që operojnë në Shqipëri ose jashtë saj. Për këto qellime shoqëria mund të japë si garanci barre mbi pjesët e kapitalit ose sende të paluajtshme, me autorizim të Asamblesë së Ortakeve të Shoqërisë.

#### **Neni 20**

#### **Te ardhurat. Dividendi**

- 20.1 Shoqëria do të krijojë fonde rezerve për realizimin e objektivit të saj.
- 20.2 Te ardhurat që do të rezultojnë në fund të mbylljes së çdo ushtrimi, pas pagimit të tatimeve, mund të terhiqen nga ortakët I vetem i shoqërisë.

#### **Neni 21**

#### **Likuidimi**

- 21.1 Shoqëria do të hyjë në procesin e likuidimit, nëse:
- gjendja ekonomike në Shqipëri nuk do të lejojë vazhdimin e veprimtarisë së shoqërisë;
  - Asambleja e Ortakut të vetem, vendos të prishe shoqëritë.
- 21.2 Në mënyrë që të ndermarret procedurat e likuidimit, Asambleja e Ortakut të vetem emëron një likuidator ose një grup likuidatorësh.
- 21.3 Likuidatori/likuidatoret raportojnë mbi gjendjen e zerave të aktivitetit dhe të pasivitetit të shoqërisë rreth operacioneve të mëtejshme të likuidimit dhe kohën që nevojitet për perfundimin e tij. Në fund të këtij procesi, Asambleja e Ortakut të vetem shqyrton bilancin perfundimtar dhe mbylljen e procedurës së

likuidimit.

**Neni 22**

**MOSMARREVESHJET DHE DISPOZITAT E FUNDIT  
ZGJIDHJA E MOSMARREVESHJEVE**

Te gjitha mosmarreveshjet qe mund te lindin gjate ekzistences se Shoqerise ose gjate periudhes se likuidimit do t'i paraqiten per zgjidhje Gjykatës Kompetente Shqiptare.

**NENI 23**

**DISPOZITA E FUNDIT**

Pasuria e Shoqerise mund te sigurohet ne ndonje Institut Sigurimi si brenda ashtu edhe jashte Shqiperise. Shoqeria do te kete vulen e saj, forma dhe madhesia e se ciles do te percaktohen nga ortaku i vetem.

Administratori i Shoqerise eshte Z. Avni Mula dhe do te qendroje ne kete detyre per nje periudhe 5 vjecare.

Ky akt themelimi eshte hartuar ne 3 (tre)kopje, ne gjuhen shqipe, duke patur secila fuqi te njejte ligjore.

**ORTAKU I SHOQERISE**

**AVNI MULA**



**Tirane, me 15.02.2023**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË  
DEGA VENDORE TIRANË  
NOTER ARTA GJ. PJETËRNIKAJ



V2023052690015192823

DATE 15/02/2023  
NR REP 432



VËRTETIM NËNSHKRIMI

Sot, më datë 15/02/2023, para meje Notere ARTA GJ. PJETËRNIKAJ, anëtare në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore TIRANË, me zyrë në adresën Tirane, NR.9, DERVISH HATIXHE, NR.64, NR.1, NR.1, u paraqit personalisht:

**NËNSHKRUES/IT:**

Avni Mula, atësia Vebi, amësia Xhemile, shtetas Shqiptar, lindur në Kukës dhe banues në Tiranë, me adresë Jordan Misja; Nd. 42; H. 1; Ap. 42; Njësia Administrative Nr. 9; Njësia Bashkiake Nr. 9; 1016; Tiranë, lindur më 10/04/1986, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 034322946 dhe nr. personal I60410151K.

Subjekti i mësipërm, në vullnet të lirë dhe të plotë, u paraqit dhe nënshkroi përpara meje Noteres dokumentin "Akt Themelimi" i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar " **DENIS CONSTRUCTION**" **SHPK** ne themelim e siper, perpiluar prej tij jashte kesaj zyre noteriale dhe deklaroi se eshte plotesisht dakort me permbajtjen e tij.

Unë Noteri/ja, pasi verifikova identitetin e personit të sipërcituar, nëpërmjet mjetit të identifikimit në përputhje të plotë me nenin 62, pika 1, gërma "ë", si dhe nenit 128 të ligjit nr. 110/2018 "Për Noterinë", dhe Udhëzimit të Ministrisë së Drejtësisë nr. 6291, datë 17.08.2005; vërtetoj nënshkrimin e tij.

Në zbatim të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave Personale", unë noterja deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjektit të këtij veprimi në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

NOTER

ARTA GJ. PJETËRNIKAJ